

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
ALLIANCE ING**

Ne kete statut

- "Ligji" eshte Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare";
- "Statuti" eshte Statuti i shoqerise;

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

(1) Sot, me 06/09/2022 themeluesi, ka krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin "ALLIANCE ING" shpk

(2) Themeluesi i shoqerise është: **Bledar Korkaj**, shtetas shqiptar, lindur ne Vlore me 11.05.1979 dhe banues ne Tirane, identifikuar me numer leternjoftimi H90511157W.

**Neni 2
Objekti**

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem:

2.1 Studim tregu, konsulence ne fushen e marketingut dhe manaxheriale, sherbime per transakcionet e blerjes dhe shitjes se kapitaleve dhe te pronave, rekrutim dhe trajnim profesional si dhe sherbime te lidhura me to. Subjekti mund te kryeje te gjitha aktivitetet qe do te konsiderohen te nevojshme per permbushjen e objektit te saj, dhe çdo aktivitet tjetër ne sherbim te objektit kryesor te veprimtarise i lejuar nga ligji shqiptar;

2.2 Gjithashtu shoqëria mund te kryeje cdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë cdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

2.3 Shoqëria, me vendim të administratorit, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arrijten e objektit të veprimtarisë së saj.

**Neni 3
Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqerise do te jete pa afat.

**Neni 4
Selia**

Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: Rruga Dervish Hima, Hyrja 1, apartamenti 28, nr.pasurie 6/429+1-28, zona kadastrale 8160, vol 46, f.66, Tiranë.

Kreu II kapitali

Neni 5 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise "ALLIANCE ING" Sh.p.k perfaqesohet nga 1 (nje) kuote me vlere 12,000 (dymbedhjete mije) leke dhe nuk eshte paguar.

Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise:

- **Z. Bledar Korkaj** Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere të 12,000 (dymbedhjete mije) leke qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Neni 6 Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

6.1 Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga asambleja e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

6.2 Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

6.3 Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

6.4 Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 7 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar janë lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e kapitalit themeltar janë lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8 Organi Vendimmarres

8.1 Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

8.2 Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

8.3 Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) ndryshimet e statutit;
- b) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të eksperteve kontabel të autorizuar;
- d) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- h) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- i) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblese;
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

8.4 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblet e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

8.5 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakeve në asamblet e përgjithshme.

Neni 9

Menyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme

9.1 Mbledhja e asamblese bëhet së paku një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e pasqyrave financiare, raportin e administratoreve, ekspertin kontabël dhe inventarin.

9.2 Mbledhja e Aksionarëve mund të thirret në çdo kohë nga një prej administratorit ose nga likuiduesi / likuiduesit dhe gjithashtu nga një ose disa prej ortakeve bazuar në dispozitat e legjislativës në fuqi.

9.3 Asambleja thirret përmes njoftimit me letër të me lajmerim marrje e cila duhet u dërgohet ortakeve - në adresën e treguar në librin e ortakeve - dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), së paku 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para mbledhjes së Asamblese. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e takimit, për çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendimi, mbi vendimin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.

9.4 Asambleja mund të mbledhet edhe jashtë selisë së kompanisë, në Itali ose në Shqipëri.

9.5 Asambleja do të mbledhet dhe zhvillohet rregullisht edhe në mungesë të pajtueshmërisë me formalitetet e njoftimit, kur janë prezent ortaket që përfaqësojnë tërë kapitalin e shoqërisë.

Neni 10

Kuorumi

10.1 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, për të cilat kërkohet një shumicë e zakonshme, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm anëtarë me të drejtë vote, të cilët mbajnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, për të cilat kërkohet një shumicë e cilësuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm anëtarët me të drejtë vote, të cilët mbajnë së paku 51% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit.

10.2 Asambleja e Përgjithshme vendos për modifikimet e statutit, rritjen ose zvogëlimin e kapitalit, transferimin e kuotave, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe shpërbërjen e shoqërisë me

votim (tre të katërtat) të ortakeve pjesëmarrës, të cilat përfaqësojnë të paktën 51% (pesëdhjetë për qind) të kapitalit të shoqërisë. Në të gjitha rastet e tjera, Asambleja e Përgjithshme merr vendime në mbledhjet e zakonshme me votën pro të shumicës së ortakeve të pranishëm që përfaqësojnë më shumë se 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit.

10.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të cituar, asambleja thirret përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njëjtën rend dite.

Neni 11 Marrja e vendimeve

11.1 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakeve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të eksperteve kontabel të autorizuar;
- d) mbikeqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblese;

11.2 Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 12 Administrimi

12.1 Shoqëria administrohet nga 1 (një) Administrator i cili emërohet për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh deri në momentin e revokimit ose doreheqjes nga ana e tij.

12.2 Administratori posedon të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe të veçantë të Shoqërisë brenda kufijve të objektit të shoqërisë, përveç atyre kompetencave që në bazë të legjislacionit ose Statutit i takojnë Asamblese.

12.3 Administratori i parë i Shoqërisë emërohet Znj. Pamela Pëllumbi, shtetase shqiptare, lindur në Kucovë më 08.10.1998, identifikuar me nr. letërnjoftimi J86008038Q madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Nenshkrimi i administratorit: Pamela Pëllumbi



Administratori ka të gjitha kompetencat e përcaktuara nga ligji dhe statuti i shoqërisë.

Neni 13 Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

- c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- d) pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
- e) krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- f) kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise, si parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- g) raporton perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- h) kryen detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Neni 14 Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Perveç sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

- a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;
- b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- c) te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendim;
- d) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;
- e) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

Kreu IV

VITI FINANCIAR

Neni 15

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Kreu V

Prishja-riorganizimi i shoqerise

Neni 16

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) me vendim te Asamblese se Ortakeve;

b) me hapjen e procedurave te falimentimit;

Neni 17
Riorganizmi i shoqerise bashkimi-ndarja

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare."

Neni 18
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 19
Mosmarveshjet

Per mosmarveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 20
Kopjet

Ky dokument redaktohet ne 4 (kater) kopje origjinale dy ne gjuhen shqipe dhe dy ne ate italiane.

Lexuar, kuptuar, aprovuar e nenshkruar nga ortaku themelues.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE

Bledar Korkaj

